

L I G J
Nr. 8720, datë 26.12.2000

PËR KRIJIMIN E POLICISË FINANCIARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Policia Financiare krijohet për organizimin e luftës kundër krimit ekonomik dhe financiar dhe për zbatimin e legjislacionit financiar.

Neni 2

Policia Financiare është organ i specializuar, me status civil në varësi të ministrit të Financave.

Neni 3

Policia Financiare ka këto detyra:

- Parandalon, zbulon dhe lufton krimin dhe veprimtaritë ekonomike e financiare të paligjshme, duke respektuar garancitë kushtetuese për liritë dhe të drejtat e njeriut.
- Kontrollon për zbatimin e përpiktë të dispozitave ligjore në fushën ekonomike dhe financiare nga subjektet private e publike, juridike dhe fizike.
- Zbaton sanksionet ligjore të vendosura nga autoritetet qendrore dhe vendore të administratës financiare.
- Kontrollon zbatimin e legjislacionit fiskal nga subjektet tatimpaguese, sipas akteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.
- Kryen funksionet që kërkohen nga ligje të tjera.
- Mbron dhe mbështet veprimtarinë e administratës tatimore, me kërkesë të kësaj të fundit, si dhe ekzekuton sanksionet e vendosura nga kjo administratë ndaj tatimpaguesve.

Neni 4

Punonjësit e Policisë Financiare, për të kryer detyrat e ngarkuara, pajisen me armatim dhe mjete teknike të përshtatshme, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Punonjësit e Policisë Financiare kanë uniformën dhe shenjat dalluese të kësaj policie, si dhe dokumentin identifikues të përcaktuar me akte nënligjore.

Neni 5

Policia Financiare organizohet si vijon:

1. Struktura qendrore ku përfshihen Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Financiare dhe drejtoritë qendrore.
2. Struktura vendore përbëhet nga drejtoritë rajonale.
3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të Financave, miraton strukturën organizative, organikën, si dhe numrin e punonjësve të kësaj policie.

Neni 6

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Financiare është organi më i lartë organizativ dhe teknik brenda saj. Ajo drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili, gjatë ekzekutimit të detyrave të veta, mbështetet nga Ndërdrejtori i Përgjithshëm, i cili, në mungesë të tij, vepron brenda kufijve të përgjegjësisë të deleguara nga ai.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Financiare emërohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit të Financave. Ministri i Financave propozon për Drejtor të Përgjithshëm të Policisë Financiare një nga drejtorët ose nëndrejtorët e përgjithshëm në Ministrinë e Financave, në Ministrinë e Mbrojtjes ose në Policinë e Shtetit. Mandati i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Financiare është tre vjet me të drejtë riemërimi vetëm një herë.

Nëndrejtori i Përgjithshëm emërohet nga ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Financiare, duke pasur parasysh përvojën, aftësinë dhe vjetërsinë në punë në sektorin e policisë. Drejtorët e drejtorive qendrore dhe të drejtorive rajonale emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Financiare.

Neni 7

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Financiare ka këto detyra:

- Ndërmerr dhe kryen të gjitha veprimtaritë institucionale, konform ligjeve, si dhe udhëzimeve të ministrit të Financave.
- Drejton, bashkërendon dhe kontrollon veprimtaritë operationale që kryhen nga drejtoritë qendrore dhe vendore të Policisë Financiare.
- Mban lidhje të vazhdueshme me drejtorët e përgjithshëm të strukturave të tjera të administratës publike, me drejtuesit e forcave të tjera të policisë dhe me organin e prokurorisë.
- Ndërmerr dhe zbaton veprimtari për organizimin dhe përdorimin e burimeve njerëzore dhe teknike, që ka në përdorim Policia Financiare.

Neni 8

Drejtoritë qendrore kanë juridiksion në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kryejnë:

1. veprimtari të specializuara;
2. investigimet më të rëndësishme.

Drejtoritë vendore të Policisë Financiare organizohen në nivel rajonal.

Drejtoritë qendrore dhe vendore, nga pikëpamja hierarkike, administrative dhe funksionale varen nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Financiare. Për veprimtari të kufizuara, që kanë të bëjnë me shkelje administrative, ato varen, gjithashtu, edhe nga organet financiare vendore.

Për shërbimet që kryejnë, me kërkesë të organeve financiare, drejtorët qendrorë dhe ata vendorë veprojnë sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin financiar dhe sipas udhëzimeve që marrin nga drejtuesi i organit financiar.

Drejtorët qendrorë dhe vendorë, për shërbimet që kryejnë me nismën e tyre, veprojnë në mënyrë të pavarur.

Neni 9

Sipas detyrave dhe funksioneve që kryejnë në polici, punonjësit e saj ndahen në këto kategori:

- të mesëm
- të lartë
- madhorë

Kriteret për emërimin e personelit në kategoritë e mësipërme përcaktohen me akte nënligjore.

Pjesëtarët e Policisë Financiare, gjatë veprimtarisë së tyre, ushtrojnë një funksion publik, duke pasur atributet e oficerëve dhe të agjentëve të policisë gjyqësore.

Drejtori i Përgjithshëm dhe Ndërdrejtori i Përgjithshëm i Policisë Financiare, si kategori madhore e kësaj Policie, nuk gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore.

Neni 10

Policia Financiare, në ushtrimin e detyrave kundër veprave penale në fushën ekonomike dhe financiare, e kryen veprimtarinë e saj në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe të ligjeve të tjera të lidhura me të.

Neni 11

Pjesëtarët e Policisë Financiare, në kontrollet e një natyre administrative, kanë të gjitha të drejtat që jepen me ligj për të hyrë, kontrolluar, inspektuar, vërtetuar, siç parashikohet në dispozitat ligjore për organet financiare.

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 12

1. Policia Tatimore deri më 30 qershor të vitit 2001 do të vazhdojë të jetë në varësi të drejtpërdrejtë të administratës tatimore, me organizimin dhe organikën efektive në fuqi.

2. Rekrutimi dhe përzgjedhja e punonjësve të Policisë Financiare bëhet në pajtim me kriteret që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit të Financave.

3. Këshilli i Ministrave siguron fondet e nevojshme për krijimin e kushteve për funksionimin e Policisë Financiare.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 13

Dekreti i Presidentit të Republikës së Shqipërisë nr.1074, datë 21.4.1995 “Për shpërbërjen e Policisë Financiare dhe krijimin e Policisë Tatimore”, ligji nr.7938, datë 24.5.1995 “Për miratimin e ndryshimeve të dekretit nr.1074, datë 21.4.1995” dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen ditën që Policia Financiare fillon veprimtarinë e saj sipas nenit 15 të këtij ligji.

Neni 14

Veprimtaria, organizimi dhe funksionimi i hollësishëm i Policisë Financiare bëhet me ligje të veçanta.

Neni 15

Veprimtaria e Policisë Financiare fillon më 1 korrik 2001.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2863, datë 9.1.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.